



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

THIRRJE PËR DONACION

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural kërkon vëmendjen e subjekteve të interesuara lidhur me mundësinë për të kontribuar nëpërmjet donacionit, për disa nevoja të punës në këtë Institucion.

- 1- Projektimin e 15 zyrave të reja të Agropikave, të cilat do të hapen në 15 rrethe të ndryshme në vend. Agropikat organizohen si degë territoriale të AZHBR dhe janë njësi të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve ndaj fermerëve në Republikën e Shqipërisë, të krijuara me Urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në kuadër të hapjes së 15 Agropikave të reja, për të ofruar shërbimet lehtësuese ndaj fermerëve, dhe duke qenë përballë një afati të limituar kohor për projektimin e zyrave të reja, lind nevoja për mbështetje në këtë proces.

Kërkohe projektimi i zyrave të Agropikave në këto rrethe: **Berat, Gjirokastrë, Shkodër, Lezhë, Dibër, Mat, Sarandë, Përmet, Kavajë, Pukë, Librazhd, Elbasan, Pogradec, Kukës, Tiranë.** Ambientet e zyrave kanë një sipërfaqe mesatare prej 40 m². AZHBR disponon aktet e marrjes në përdorim/administrim të 15 zyrave, si dhe planimetritë përkatëse.

- 2- Rikonstruksionin e pjesshëm të zyrave dhe/ose lyerjen e fasadës së godinës së AZHBR Qendër. Duke qenë se godina e AZHBR nuk është restauruar/rikonstruktuar prej disa vitesh, ka lindur nevoja e rikualifikimit të fasadës/lyerjes së saj, rikonstruksionit të zyrave qendrore, si dhe përshtatjes së ambienteve me rritjen e strukturës organizative.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

- 3- Pajisjen me rafte metalike për mbajtjen e dosjeve për arkivën/protokollin. Për mirëfunksionimin e punës së zyrës së arkivës dhe protokollit në AZHBR, është e domosdoshme pajisja me rafte metalike për këto zyra. Raftet duhet të jenë sipas specifikave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9154 “Për Arkivat” të parashikuara në specifikimet teknike të hartuara nga Institucioni.
- 4- Pajisje teknologjike, kompjutera etj.
- 5- Rikonstruksion dhe përshtatje të dhomës së serverave.

Subjektet e interesuara janë të lutura të paraqiten pranë AZHBR, për të marrë setin e dokumentacionit, i cili është i rregullt dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Duke ju falenderuar dhe shpresuar në bashkëpunimin e frytshëm midis palëve.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL